



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr. 6, datë 01.02.2019

PËR
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR MIRATIMIN
E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË
UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS KANALIZIME
TROPOJË

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**ligji nr. 8102**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 09.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 40**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 09.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 41**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 09.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 42**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 01.02.2019 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Drejtoria Juridike mbi kërkesën e Ujësjetllës Kanalizime Tropojë sh.a për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura,

Konstatoi se:

Shoqëria UK Tropojë është licencuar nga ERRU, me vendimin e KKRR nr.40 datë 01.06.2018, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tropojë" pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale, bazuar në pikën 3, të kreut II të VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura".

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tropojë ka aplikuar pranë ERRU me shkresën nr. 119 prot. datë 19.12.2018, me lëndë "Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të

pijshtëm" bazuar në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për përmirësimin e saj pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale.

Shoqëria UK Tropojë plotësoi dosjen e aplikimit me shkresën nr. 07 prot, datë 10.01.2019 me të cilën përcolli dokumentin "Vendimi i Organit Drejtues për nivelin e ri të tarifave të kërkuara".

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Tropojë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në Vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tropojë sh.a. për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.
2. Drejtoria Tekniko Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Tropojë sh.a. dhe Bashkinë Tropojë për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.